



**Republika e Kosovës / Republic of Kosova**  
**Komuna - Municipality**  
**Hani i Elezit**



01/Nr. 176 /2021  
Data: 11.01.2021

**PROCESVERBALI**  
**I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e dymbëdhjetë -XII- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 22.12.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i planit të punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2021.
3. Shqyrtimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2021.
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell, ndërkohë ju kemi dërguar edhe dy pika shtesë, shqyrtimi i propozim vendimit për pagesën e shujtës për të gjithë të punësuarit në administratën e komunës, shqyrtimi i kërkesës së z.Avdi Dernjani për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Për pikat shtesë të cilën e kemi përcjell hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedhe në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

**Procedojmë me këtë rend të punës:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i planit të punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2021.
3. Shqyrtimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2021.
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për pagesën e shujtës për të gjithë të punësuarit në administratën e komunës.
5. Shqyrtimi i kërkesës së z.Avdi Dernjani për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
6. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Shqyrtimi i planit të punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2021.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:-në këtë periudhë kohore janë planet e punës që bëhen për vitin që vijon dhe administrata e komunës ka bërë një plan që janë objektivat e përgjithshme si administratë komunale dhe objektivat e veçanta sipas drejtorive. Materiali është përcjell me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- shtimi i kapaciteteve të ujë për të cilin është bërë marrëveshja kontraktuale në mes CDI-së , kompaninë “Bifurkacioni “ a është për shtim të kapaciteteve apo për përmirësim të kapaciteteve të ujit, kërkoj sqarim të dijë se cili është roli i kompanisë “Bifurkacioni “ në këtë rast që ka me ndikuar në shtimin e kapacitete për shkak se ne e dimë menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit aktual. Planifikimi në infrastrukturë parashihet rregullimi i parkut te rruga “Isa Berisha” dhe në cilën pjesë ka të bëjë që parashihen të investohen 1000 € , ndërsa 5000 € në mirëmbajtje të trotuareve. Në shumicën e rasteve e ke shtrimi i rrugëve me kupëza betoni në zonat rurale dhe urbane që përsëriten , kërkoj sqarim se pse nuk janë specifikuar këto në mënyrë që me u paraparë me një objektive. Doket që këto shuma janë pak kontraverse për shkak se shumë janë për mirëmbajtje dhe pakë janë të planifikuara për rregullimin e asaj pjese.

**Mallzum Qajani** thekson:- CDI dhe komuna e Hanit të Elezit e kanë një aktivitet që në vitin 2008 ka filluar ndërtimi i fabrikës dhe që nga atëherë e deri më sot nuk është zgjidhë problemi i ujit në komunën e Hanit të Elezit. Në marrëveshjen e fundit që e kemi pasur me CDI-në kompaninë “Bifurkacioni “ dhe komuna , CDI-ja është zotuar që do të ndanë shumën prej 300 000 € , ndërsa pjesën tjetër do ta shtonë komuna që parashihet një pjesë rehabilitim , rehabilitim në tërësi i fabrikës së ujit dhe vendosja nën kontroll e ujit. Kompania “Bifurkacioni “ i ka marr obligimet në vitin 2008 por nuk i ka kryer dhe tash i ka marr obligimet në pjesën që ka njëzorë dhe që është uji i pijshëm që është uji nga burimi i fshatit Gllloboqicë, ndërsa pjesën që është uji i fshatit Dimcë deri sa mos turbullohet ata nuk e marrin në menaxhim , kështu që me meremetimin e fabrikës dhe të disa segmenteve të saj mendojmë që do të vendoset në kontroll uji në Han të Elezit që është mendim profesional i CDI-së . Projektet janë pjesë e buxhetit që është miratuar në shtatorë dhe projektet që kanë paraqitur janë kopi pastë prej shtatorit që i ka miratuar kuvendi dhe nuk mund të ndryshohen, ndërsa që u potencua që kontraverse ndoshta nuk ta mbushin mendjen sepse nga një herë edhe neve nuk na i mbushin mendjen por zakonisht na planifikojmë projekte dhe kërkojmë donacione për realizimin e projekteve të cilat i keni paraqitur si prioritare. Kemi shumë projekte dhe kur i shënojmë e dimë që ndoshta nuk mund të realizohen por i paraqesim si projekte me mundësi që ti realizojmë përmes ndonjë donacioni. Rruga që del te shkolla fillore bëhet fjalë për parkun.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-ndoshta mund të jetë plan i shtatorit të cilin ne nuk e kemi miratuar si opozitë , por ka qenë kërkesë e ka hershme që me u specifikuar. Në plan vërejtja pak specifika kurse tjerat ishin kopi pastë sepse kur janë bërë planifikimet për vitin 2021,2022, 2023 keni mundur me i specifikuar projektet nëse thuhet për zonën e gjelbërimit me trotuaret dhe mirëmbajtjen e trotuareve dhe për atë them që është kontravese se është dashur me u specifikuar. Marrëveshja me kompaninë “Bifurkacioni” është nënshkruar gati qe dy vite por nuk besoj që do të ketë diçka në shtim të kapaciteteve të ujit. Si do të funksionon tash fabrika e ujit kur nuk ka funksionuar kur është ndërtuar.

**Mallzum Qajani** thekson:-ato janë projekte të cilat i ka miratuar kuvendi i komunës, kryetari i komunës dhe nënkryetari as nuk munden me ja ndërruar emrin dhe as nuk munden me ja ndërruar shumën. Fabrika edhe në vitin 2008 ka qenë në rregull por “Bifurkacioni” nuk e ka marr obligimin e vetë me mirëmbajtur ujin në Han të Elezit. Në vitin 2010 është lëshuar fabrika në përdorim dhe ka qenë funksionale është përpunuar uji dhe kapaciteti më i madh ka qenë 20 litra në sekondë , kur uji është i turbullt kapaciteti i ujit bien dhe kompania “Bifurkacioni” nuk ka ardhur me mirëmbajtur. Komuna e ka themeluar kompaninë publike por ministria ka kërkuar që kuvendi ta shfuqizon vendimin dhe nëse nuk e shfuqizon do të ndëshkoheni nga ministria përkatëse dhe fabrika mbet pasi që nuk kishte kush me menaxhuar ujin dhe me menaxhuar fabrikën . Nëse vendoset nën kontroll uji ndoshta mund të kemi probleme dy muaj verës por nuk kemi probleme dymbëdhjetë muaj .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- çka nëse në mënyrë hipotetike keni paraparë që mund të ketë ujë por mund të ketë probleme vetëm dy muaj brenda vitit. Nëse ju mendoni se ndoshta nuk mund të ketë ndonjë zgjidhje por cilat janë masat që keni me i marr ndaj marrëveshjes që nuk realizohet në këtë rast apo vetëm prova po bëni për shkak se janë bërë prova në vitin 2008 dhe ndoshta po e bëni edhe një provë në vitin 2021.

**Mallzum Qajani** thekson:-unë mendojë që nuk është hipotetike për shkak se e kanë paraparë ekspertët. Nëse të doket që është provë fabrika është tjetër problem për shkak se nuk jemi duke e bërë prova. Ne kemi nënshkruar marrëveshje për me realizuar planin.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 4 për , 1 kundër (grupi parlamentarë i PDK-së).

U VOTUA PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 3. Shqyrtimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2021.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- në këtë plan janë paraqitur aktivitetet për vitin 2021, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në kuvend nuk po kemi asnjë sqarim për diskutimet të cilat po bëhen brenda mbledhjeve të KKSBB- së edhe pse kam kërkuar disa herë që të jenë të specifikuar diskutimet dhe vendimet që janë marr në këtë këshill për shkak se vetëm po diskutohen ndërsa problemet po janë permanente. Vërejtje kam që së paku të jenë më të kujdesshëm kur ka të bëjë për sigurinë sepse ka shumë çështje që diskutohen e nuk po merret vendim për me marr masa për me i parandaluar. Ne e kemi paraqitur problemin e sigurisë së fëmijëve që kam kërkuar disa herë vendosjen e mbrojtëseve te rruga për Gorancë që është para dy viteve ishte një aksident që humb jetën një fëmijë dhe ende nuk janë marr masa. Në plan është paraparë prerja e drunjve dhe objekteve të tjera që e rrezikojnë sigurinë e qytetarëve është mirë të modifikohet më ndryshe. Në plan është paraparë luftimi i ekstremizmit të dhunshëm është mirë edhe kjo të modifikohet.

**Teuta Shkreta** thekson:-rruga që është te kufiri që shkon në drejtim të fshatit Seqishtë po krijohet tollovijë e veturave është mirë që organet përgjegjëse me vepruar në momentet kur krijohet tollovijë .

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA U VOTUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

#### 4. Shqyrtimi i propozim vendimit për pagesën e shujtës për të gjithë të punësuarit në administratën e komunës.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- sindikatat e ndryshme të sektorëve të ndryshëm kanë nënshkruar marrëveshje ose kontrata kolektive. Arsimi ka kërkuar dhe disa komuna i kanë obliguar përmes sindikatës dhe zyrtarët e komunës kanë kërkuar që nëse kompensohen tjerët të kompensohen edhe ata , mirëpo na as s'jemi kundër por janë shumë mjete financiare dhe nëse na dalin këto probleme gjatë viti 2021 kemi me pasur probleme serioze por me shifra do t'i sqaron drejtori për buxhet dhe financa.

**Shabi Rexhallari** thekson:-në kërkesë mungon propozim vendimi se prej cilës kategori me i marr mjetet financiare por për mbledhje të kuvendit duhet të përgatitet propozim vendimin në kordinim me drejtorinë e financave. Nëse miratohet në kuvend propozim vendimi do të përcillet në MPL për shqyrtim të ligjshmërisë. Nëse kthehet shqyrtimi i ligjshmërisë për drejtorinë për buxhet e financa përmes kategorisë paga dhe mëditje do ta ekzekutonim më lehtë , mirëpo deri më tani në asnjë komunë shërbyesit civilin nuk i kanë marr përmes pagave për shkak se Ministria e Financave nuk e ka lejuar , nëse merren mjetet përmes kategorisë për mallra dhe shërbime është keq klasifikim sepse ligji i buxhetit e parasheh. Jemi për me u dhënë shujtat por për format se si do të bëhet nuk e di. Nëse vendimi konfirmohet i ligjshëm prej MPL do ti shikojmë format se si do ta ekzekutojmë vendimin.

**Kryesuesi** thekson:- ne jemi pro miratimit mirëpo ndoshta do të jetë problem për me u realizuar për shkak se në kategorinë paga dhe mëditje nuk na lejohet dhe na kthehet nga ministria , kurse te mallrat dhe shërbimet është keq klasifikim siç potencoi drejtori për buxhet e financa , ndërsa te subvencionet dhe transferet nuk kemi mjete të mjaftueshme.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë jam pro miratimit të kësaj kërkesë sepse kanë bërë një kërkesë të ligjshme dhe të nevojshme për shkak edhe të pandemisë, mirëpo mu po më vjen keq sepse gjithmonë po duhet me bërë një lloj presioni komunës siç ka qenë edhe kërkesa për shujtat e arsimtarëve. Në fillim kemi kërkuar që me u kërkuar shujtat e arsimtarëve përmes marrëveshjes në mënyrë që mos me shkuar përmes procedurave gjygsore. Unë jam pro miratimit të sajë por duhet të jetë një vetëdijesim që kur të miratohet buxheti të planifikohen këtë çështjet dhe mos të bëhet manipulim me anëtarët e kuvendit që miratone buxhetin ashtu siç e kemi paraqitur na si ekzekutiv.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR PAGESËN E SHUJTËS PËR TË GJITHË TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN E KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**5. Shqyrtimi i kërkesës së z.Avdi Dernjani për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- ligji dhe udhëzim administrativ e përcakton kategorinë se për cilat prona ndërrim destinimin e bënë kuvendi i komunës. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë diskutim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA KËRKESA E AVDI DERNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**6. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**

